

Këshilli i Qarkut Korce ofron partneritet, koordinim dhe mirëkuptim midis të gjithë partnereve lokale e rajonale per pjesemarje në projekte gjithepërfshirëse. Keshilli i Qarkut ofron partneritetin e tij per pjesemarje ne Programet nderkuftare te financaura nga Bashkimi Europiane, etj.me synim zhvillimin ekonomiko social te Rajonit dhe ritjen e cilesise se sherbimeve per komunitetin.

OBJEKTIVAT E KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2018

Disa nga objektivat kryesore te Keshillit te Qarkut per vitin 2018:

- *Hartimi dhe zbatimi i politikave rajonale dhe harmonizimi i tyre me politikat e qeverisjes qendrore.*
- *Hartimi i Planit Sektorial për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik për territorin e Qarkut Korce.*
- *Pjesemarja ne Programet nderkuftare e me gjere dhe krijuimi i partneriteteve për një zhvillim të qëndrueshëm rajonal.*
- *Nxitjen e bashkëpunimit midis njesive te qeverisjes vendore te Rajonit, si dhe bashkëpunimin nderrajonal.*
- *Permiresimi i shërbimeve të ofruara komunitetit dhe sigurimi i një qeverisje më të mire.*
- *Përmiresimi i rolit të Qarkut dhe njësive përbërëse të tij, në procesin e Integrimit European.*

REALIZIMI I BUXHETIT TE KESHILLIT TE QARKUT PER PERIUDHEN 8/MUJORE 2018

Zbatimi i Buxhetit te Keshillit te Qarkut per periudhen 8/mujore 2018 ka ecur ne kushte normale, kjo si rezultat i nje planifikimi te mbeshtetur mbi burime reale te te ardhurave te vete Institucionit si dhe nje menaxhim te mire te shpenzimeve ne funksion te realizimit te aktiviteve dhe programeve te planifikuara per kete vit.

Burimet e financimit :

- Të ardhurat e vetë Institucionit
- Transferta e Pakushtëzuar (Granti)
- Transferta e Kushtëzuar

Funksionet kryesore të strukturave financiare :

- Për funksionet e veta
- Për funksionet e përbashkëta
- Për funksionet e deleguara

➤ Analiza e realizimit te te ardhurave per periudhen 8/mujore 2018

Të ardhurat e veta per vitin 2018 jane parashikuar sipas metodës dinamike duke marrë ne konsiderate të dhënët e ecurisë së arkëtimeve të viteve të fundit, dhe realizimit faktik të vitit 2017.

Llojet e të ardhurave që ka arkëtuar institucioni gjatë 8 mujorit, viti 2018 kanë qenë si më poshtë: